Përmbajtja

HYRJE 3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 4
DEPARTAMENTI I FINANCAVE 5
Të ardhurat dhe fitimet 5
Shpenzimet 6
DEPARTAMENTI SHITJE DHE MARKETING 8
DEPARTAMENTIT TË SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA 9
FURNIZIMI DHE PRODHIMI 12
Prodhimi i shujtave gjatë Tremujorit II 2026 13
MENAXHIMIN E KONTRATAVE 14
Kontratat me KQ 2025/2026 17
BURIMET NJERËZORE 18
ZYRA E PROKURIMIT 21
KONTROLLI I CILËSISË DHE SIGURISË USHQIMORE 22
KONKLUZION 24

HYRJE

Ky raport paraqet aktivitetet, rezultatet dhe zhvillimet kryesore të realizuara nga **N.P.L. "Ku'zina" Sh.A.** gjatë **Tremujorit II të vitit 2026**, për periudhën **01 prill – 30 qershor 2026**.

Raporti është përgatitur me qëllim të informimit të Bordit të Drejtorëve mbi realizimin e objektivave operacionale, administrative dhe financiare të ndërmarrjes, duke ofruar një pasqyrë të qartë të punës së secilit departament, rezultateve të arritura, sfidave të hasura dhe masave të ndërmarra për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës.

Gjatë kësaj periudhe, N.P.L. "Ku'zina" Sh.A. ka vazhduar të ushtrojë veprimtarinë e saj në përputhje me misionin për ofrimin e shërbimeve cilësore të përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit për institucionet publike të Komunës së Prishtinës, duke respektuar standardet më të larta të cilësisë, sigurisë ushqimore, transparencës dhe menaxhimit të përgjegjshëm të burimeve.

Në raport janë përfshirë aktivitetet e realizuara nga Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta, Zyra e Prokurimit, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra për Menaxhimin e Kontratave, sektori i Kontrollit të Cilësisë dhe Sigurisë Ushqimore, si dhe sektori i Furnizimit dhe Prodhimit. Gjithashtu, raporti paraqet të dhëna mbi realizimin e procedurave të prokurimit, menaxhimin e kontratave, prodhimin dhe shpërndarjen e shujtave, zhvillimin e burimeve njerëzore, kontrollin e cilësisë dhe sigurisë ushqimore, si dhe aktivitetet mbështetëse që kanë mundësuar funksionimin e pandërprerë të ndërmarrjes.

Gjatë Tremujorit II të vitit 2026, ndërmarrja ka prodhuar dhe shpërndarë **388,180 shujta**, duke garantuar vazhdimësinë e shërbimeve për institucionet parashkollore, shkollat me mësim tërëditor, qendrat sociale, qendrat për të moshuar, Brigadën Profesionale të Zjarrfikësve dhe përfituesit e tjerë të shërbimeve. Paralelisht, janë zhvilluar aktivitete të rëndësishme në fushën e prokurimit, menaxhimit të kontratave, kontrollit të cilësisë, sigurisë ushqimore, zhvillimit të stafit dhe përmirësimit të proceseve të punës.

Përmes këtij raporti synohet të evidentohet niveli i realizimit të objektivave të planifikuara, të vlerësohet performanca e ndërmarrjes gjatë periudhës raportuese dhe të identifikohen fushat ku nevojiten masa të mëtejshme për rritjen e efikasitetit, cilësisë së shërbimeve dhe përmbushjen e objektivave strategjike të ndërmarrjes.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport paraqet aktivitetet dhe rezultatet e punës së N.P.L. **"Ku'zina" Sh.A.** për **Tremujorin II të vitit 2026** (01 prill – 30 qershor 2026), duke ofruar një pasqyrë të performancës së ndërmarrjes në fushat kryesore të veprimtarisë së saj.

Gjatë kësaj periudhe, ndërmarrja ka vazhduar të ofrojë shërbime të qëndrueshme dhe cilësore të përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit për institucionet parashkollore, shkollat me mësim tërëditor, qendrat sociale, qendrat për të moshuar, Brigadën Profesionale të Zjarrfikësve dhe përfitues të tjerë, duke respektuar standardet e sigurisë ushqimore dhe kërkesat kontraktuale.

Në aspektin operacional, gjatë Tremujorit II janë prodhuar gjithsej **388,180 shujta**, duke siguruar vazhdimësinë e shërbimeve për të gjitha institucionet përfituese. Proceset e furnizimit dhe prodhimit janë monitoruar vazhdimisht, ndërsa kontrollet e cilësisë kanë garantuar përputhshmëri të lartë me standardet e sigurisë ushqimore dhe sistemin HACCP.

Në fushën e kontrollit të cilësisë dhe sigurisë ushqimore janë realizuar inspektime të rregullta, analiza mikrobiologjike dhe fiziko-kimike të ushqimeve dhe ujit, kontrolle të temperaturës së magazinimit, si dhe auditime të higjienës së stafit. Në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) janë zhvilluar inspektime në shkollat me mësim tërëditor, ku për rastet e evidentuara janë ndërmarrë masa korrigjuese për përmirësimin e standardeve të higjienës dhe sigurisë ushqimore.

Në fushën e prokurimit janë zhvilluar procedura për furnizime dhe shërbime në vlerë prej **124,484.45 euro**, ndërsa janë iniciuar edhe procedura të reja strategjike për sigurimin shëndetësor dhe aksidental të punonjësve, si dhe për furnizimin me peshk dhe produkte të peshkut.

Procesi i menaxhimit të kontratave është zhvilluar në mënyrë të rregullt përmes monitorimit të kontratave aktive, analizës së performancës së operatorëve ekonomikë, kontrollit të faturave dhe fletë-dërgesave, si dhe evidentimit të realizimit financiar të kontratave. Analizat krahasuese kanë mundësuar identifikimin e ndryshimeve në shpenzime dhe përmirësimin e planifikimit të furnizimeve.

Në fushën e burimeve njerëzore është administruar me sukses struktura organizative e ndërmarrjes, janë realizuar procedurat për menaxhimin e pushimeve vjetore, është monitoruar disiplina në punë dhe janë organizuar trajnime profesionale për komunikimin, bashkëpunimin dhe menaxhimin e stresit, me qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit.

Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta ka siguruar funksionimin e pandërprerë të proceseve mbështetëse, duke koordinuar shpërndarjen e ushqimit, administrimin e

shujtave dhe faturimin, menaxhimin e higjienës së objekteve, sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe bashkëpunimin me institucionet publike dhe organizatat partnere.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar edhe aktivitete me karakter shoqëror dhe humanitar, përfshirë bashkëpunimin me organizatën **Humanity First**, e cila ka dhuruar mish viçi për përfituesit e shërbimeve sociale me rastin e festës së Kurban Bajramit, duke reflektuar përkushtimin e ndërmarrjes ndaj përgjegjësisë sociale.

Në përgjithësi, rezultatet e arritura gjatë Tremujorit II të vitit 2026 dëshmojnë një nivel të lartë të angazhimit institucional, koordinimit ndërmjet departamenteve dhe përkushtimit për përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve operative. N.P.L. "Ku'zina" Sh.A. mbetet e orientuar drejt rritjes së cilësisë së shërbimeve, përdorimit efikas të burimeve, forcimit të kontrollit të brendshëm dhe zbatimit të standardeve më të larta të sigurisë ushqimore, në funksion të përmbushjes së misionit të saj në shërbim të qytetarëve të Komunës së Prishtinës.

DEPARTAMENTI I FINANCAVE

Departamenti i financave në periudhën raportuese ka luajtur një rol të shumëfishtë në menaxhimin e aseteve financiare të ndërmarrjes, planifikimin financiar, dhe sigurimin e qëndrueshmërisë ekonomike. Roli i këtij departamenti mund të përmblidhet në funksionet e mëposhtme kryesore siç është planifikimi financiar dhe buxhetimi, kontabiliteti dhe raportimi financiar si dhe kontrolli i kostove dhe efikasiteti operativ. Gjatë periudhës raportuese, departamenti ka luajtur një rol të rëndësishëm në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe rritjes se ndërmarrjes.

Të ardhurat dhe fitimet

TM2 2026 paraqet një rritje të konsiderueshme të shitjeve krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025. Shitjet totale janë rritur me 159,687.66 ose 31%, ndërsa të hyrat nga Institucionet Parashkollore, Qendrat Sociale, Shkollat fillore, Brigada e Zjarrfikesve dhe Shtepia e të moshurave ka shënuar një rritje edhe më të lartë prej 24.31%, duke qenë faktori kryesor i performancës pozitive.

Nga ana tjetër, shitjet në sektorin privat kanë pësuar një rënie të ndjeshme prej 54.54%, duke kaluar nga 13,078.79 në 5,945.67. Kjo tregon se rritja e përgjithshme është arritur pavarësisht tkurrjes së këtij segmenti.

TM2 2026 ka qenë dukshëm më i suksesshëm se TM2 2025, kryesisht falë rritjes së fortë të shitjeve në sektorin institucional (IP, QS, SHP, BZ dhe SHF). Megjithatë, rënia e vazhdueshme në sektorin privat meriton analizë të mëtejshme për të identifikuar shkaqet dhe mundësitë për rikuperim.

Shitje TM2 2026	**IP, QS, SHP,BZ, SHF**	**Op.Privat**	**Totali**
Prill	224,095.76	2,075.78	226,171.54

Maj	233,147.46	2,800.83	235,948.29
Qershor	211,655.96	1069.05	212,725.01
Totali	668,899.18	5,945.67	674,844.84

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026, buxheti i pagave bruto arriti në **257,482.64 €,** krahasuar me **197,455.63 €** në të njëjtën periudhë të vitit 2025. Kjo paraqet një **rritje prej 60,027.01 €**, ose **30.40%.**
Kjo ka ndodhur si rezultat i rritjes së numrit të punë toreve dhe rritjes së pages bazë me 20% nga muaji Janar 2026.

Viti 2026	**Paga Bruto**
Muaji Prill	88,084.30
Muaji Maj	85,381.44
Muaji Qershor	84,016.90
Totali për tre muaj	257,482.64

Shpenzimet

Në TM2 2026, shpenzimet totale janë më shumë se dyfishuar krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, me një rritje prej 299,211.01 € ose 131.25%.

Megjithatë, kjo rritje nuk është vetëm rezultat i kostove operative. Gjatë muajit prill 2026 janë evidentuar investime kapitale në paisje për inventar në kuzhinë në vlerë 164,796.61 €, të cilat ndikojnë ndjeshëm në totalin e shpenzimeve, investime keto të realizuara me heret mirepo faturimi ka ndodhur në muajin prill. Nese krahasojme vetëm shpenzimet operative shohim që kemi pasur rritje të shpenzimeve për 58.96%.

Kategoritë e shpenzime të cilat zënë vend më së shumti në total janë : lënda e parë e cila është rritur nga viti 2025 me 70,52%, rritje e cila ë shtë në proporcion të drejtë me rritjen e shitjeve. Zeri tjeter është qirja e veturave, shpenzimet e transportit dhe shpenzimet për trajnime.

Krahasuar me vitin paraprak, ky tremujorsh karakterizohet më zgjerim të aktivitetit i cili ka reflektuar në rritjen e shitjeve si dhe rritjen e shpenzimeve. Pjesa më e madhe e shpenzimeve lidhet me investimin në asete fikse, kurse shpenzimet operative vijnë në rend të dytë .

Tabela e shpenzimeve

Viti 2026	**PRILL**	**MAJ**	**QERSHOR**	**Totali**
Totali i shpenzimve	**264,460.08**	**140,472.65**	**122,241.96**	**527,174.69**
Lënda e parë	55,795.39	78,351.46	94,941.84	**229,088.69**

Shpenzimet e ujit			510.10	**510.10**
Shpenzime për naftë	932.29	1,078.54		**2,010.83**
Shpenzime për telefon	224.24	44.25	56.77	**325.26**
Shpenzime për trajnime-avancim		16,610.20	4,599.80	**21,210.00**
Shpenzime të interneti	50.85	50.85	50.85	**152.55**
Shpenzime të rrymës		0.30		**0.30**
Shpenzime pë material shpenzues	83.05	387.31	81.57	**551.93**
Shpenzimet për zyre	22.88	85.72	74.04	**182.64**
Shpenzimet e reklamave			200.00	**200.00**
Shpenzimet e reprezentacionit		211.86		**211.86**
Shpenzimet e higjienës		566.03		**566.03**
Shpenzimet e mirëmbajtjes se veturave,sigurimi dhe servisim		734.75		**734.75**
Shpenzimet e shenderrit te veturave ne frigo	8,177.97			**8,177.97**
Shpenzimet e paketimeve		1,152.54	2,050.00	**3,202.54**
Shpenzimet e GPS-ve			101.69	**101.69**
Shpenzimet e veturave rent	6,766.10	6,766.10		**13,532.20**
Shpenzimet e transportit	771.78	14,291.16		**15,062.94**
Shpenzimet e analizave IKSHPK	1,752.06		330.00	**2,082.06**
Shpenzimet e sigurimit shendetsor	2,067.30	2,067.30	2,086.80	**6,221.40**
Shpenzimet e qeras se objektit	15,203.39	15,203.39	15,203.39	**45,610.17**
Shpenzimet e mirembajtjes se objektit	81.36	830.34		**911.70**
Shpenzimet e mirembajtjes se objektit NPB	1,277.56			**1,277.56**
Shpenzimet e qeras se kompjutereve	1,673.58	1,673.58	1,588.13	**4,935.29**
Shpenzimet e qeras se garazheve	366.97	366.97	366.97	**1,100.91**
Shpenzimet e udhetimeve jasht vendit	1,285.00			**1,285.00**
Paisje pë r Kuzhinë (Asete)	164,796.61			**164,796.61**
Shpenzimet e roletave	2,151.70			**2,151.70**
Shpenzimet e auditimit	980.00			**980.00**

Në këtë periudhë të vitit kemi pasur një aktivitet të lartë të shitjes në total 674,844.84 **euro, shpenzimet totale operative kanë arritur vleren 362,378.08 euro, shpenzimet e pagave 257,482.64 euro. Investimet në kuzhinë kanë qene te planifikuara dhe buxhetuara pë r vitin 2025 dhe nuk ndikojnë në shpenzimet totale. Kurse aktiviteti operativ merr pjese me rreth 53% të të hyrave.**

Nga kjo shohim që kjo periudhë e vitit eshtë mbyllur me rezultat pozitiv.

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, departamenti i ka kryer të gjithë detyrat dhe përgjegjësit për të cilat është i thirrur.


Është bërë përgatitja e rregullt mujore e specifikacioneve të shujtave të cilat dërgohen në baza të përditshme në Institucionet Parashkollore (IP), Qendrat Sociale, BPZ Zjarrfikësit, Qendrën Sociale për të moshuar dhe Shkollat Fillore.

Është bërë përgatitja mujore e specifikacionit dhe konstatimit për përgatitjen e faturës që i dërgohet Komunës, sipas Kontratës në shtëpi, të nënshkruar me Komunën e Prishtinës.


Ndërmarrja ka vazhduar shpërndarjen e shujtave ushqimore për Institucionet Parashkollore Publike dhe ato me bazë në komunitet, Shkollat Fillore, Qendrat Sociale Aktash dhe Tophane, Qendrat Sociale për të moshuar dhe BPZ Zjarrfikësit.

Më poshtë, mund të gjeni edhe tabelat e shpërndarjes së shujtave për tre mujorin e dytë të vitit 2026.

	Prill	**Maj**	**Qershor**
Institucionet Parashkollore Publike	31,466	30,908	32,970
Institucionet Parashkollore me bazë në komunitet	16,243	15,534	18,816
Qendrat Sociale	5,700	5,400	6,600
Qendra Sociale për të moshuar	5,781	5,910	5,898
BPZ Prishtinë (zjarrfikësit)	1,875	1,978	1,830
Shkollat Fillore	68,300	74,866	55,916
Shërbimet Catering	2 organizime 90 persona	11 organizime 630 persona	5 organizime 195 persona
Porosit private	481 porosi	345 porosi	468 porosi



Krahasuar me të njëjtën periudhë (TM2) të vitit të kaluar, ndërmarrja ka shënuar rënie të shitjeve private në baza ditore, ndërsa është shënuar rritje në shërbimet e cateringut. Gjatë kësaj periudhe janë organizuar gjithsej 18 kokteje rasti për 915 persona.



DEPARTAMENTIT TË SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026, Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta ka realizuar një sërë aktivitetesh dhe detyrash në funksion të përmbushjes së obligimeve të ndërmarrjes.

Në përputhje me rregulloret e brendshme të ndërmarrjes, si dhe me kontratën **"Në Shtëpi"** që N.P.L. **"Ku'zina" Sh.A.** ka me Komunën e Prishtinës, gjatë kësaj periudhe Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta, në bashkëpunim me Departamentin e Financave, ka

monitoruar dhe administruar procesin e shpërndarjes së shujtave në Institucionet Parashkollore. Po ashtu, është realizuar regjistrimi i shujtave dhe është përgatitur e dërguar faturimi i rregullt mujor në Komunën e Prishtinës.

Me kërkesë të Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA), departamenti ka dërguar edhe menytë ushqimore për institucionet arsimore. Kjo kërkesë erdhi si rezultat i ndryshimeve në menaxhmentin e DKA-së, i cili kërkoi informacione dhe sqarime shtesë lidhur me procesin e punës dhe organizimin e shërbimit të ushqimit në baza ditore.

Sa i përket funksioneve të departamentit, gjatë gjithë kësaj periudhe janë përmbushur me përkushtim të gjitha obligimet kontraktuale dhe operacionale.

Sektori i Shpërndarjes

Sektori i shpërndarjes ka vazhduar me sukses furnizimin me ushqim të Institucioneve Parashkollore, shkollave me mësim tërëditor, si dhe institucioneve të mirëqenies sociale.

Me kërkesë të departamentit, ndërmarrja ka shtuar kapacitetet njerëzore të këtij sektori duke angazhuar edhe dy punonjës të rinj. Pas përfundimit të vitit shkollor në muajin qershor, aktivitetet e shpërndarjes janë fokusuar në Institucionet Parashkollore dhe objektet e mirëqenies sociale.

Gjatë këtij tremujori është monitoruar zbatimi i kontratës për shërbimet e brendimit. Nga operatori ekonomik është kërkuar dorëzimi i raporteve periodike që dëshmojnë realizimin e aktiviteteve sipas kontratës.

Operatori ka dorëzuar një raport përmbledhës, i cili dokumenton punën e realizuar në përputhje me kërkesat e ndërmarrjes. Duke qenë se kontrata përfundon në muajin shtator 2026, departamenti do të vazhdojë monitorimin e saj me qëllim që të përmbyllet në mënyrë sa më cilësore dhe në përputhje me obligimet kontraktuale.

Bashkëpunimi me Humanity First

Me rastin e festës së Kurban Bajramit, ndërmarrja realizoi një bashkëpunim me organizatën humanitare **Humanity First**, e cila dhuroi 194.44 kg mish viçi.

Ky donacion u përdor për përgatitjen e shujtave për përfituesit e shërbimeve sociale. Vlen të theksohet se bashkëpunimi me Humanity First vazhdon prej disa vitesh dhe ka kontribuar vazhdimisht në mbështetjen e kategorive në nevojë dhe në realizimin e misionit social të ndërmarrjes.

Siguria dhe Shëndeti në Punë

Aktualisht, ndërmarrja ka dy zyrtarë të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë, të cilët, në koordinim me menaxhmentin, punojnë vazhdimisht për krijimin dhe ruajtjen e një

ambienti pune të sigurt, duke pasur parasysh natyrën e ndjeshme të veprimtarisë së ndërmarrjes.

Gjatë kësaj periudhe janë organizuar trajnime për sigurinë dhe shëndetin në punë për të gjithë punonjësit, me fokus të veçantë tek stafi i prodhimit dhe shpërndarjes. Gjithashtu, trajnimet kanë përfshirë edhe stafin administrativ, me qëllim të ngritjes së vetëdijes mbi përgjegjësitë dhe obligimet ligjore në këtë fushë.

Sektori i Higjienës

Përveç aktiviteteve të përditshme të mirëmbajtjes së objektit të ndërmarrjes, gjatë këtij tremujori është realizuar procesi i dezinfektimit, dezinsektimit dhe deratizimit (DDD) në objektin e mirëqenies sociale në lagjen Ulpiana.

Ky proces është realizuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale. Për arsye sigurie, objekti është mbyllur për 24 orë, duke mundësuar realizimin e plotë të procedurave të higjienës dhe mbrojtjes së sigurisë ushqimore.

Gjithashtu, në bashkëpunim me NPB-në dhe në kuadër të kontratës ekzistuese, janë realizuar disa intervenime teknike në objektin e ndërmarrjes, me qëllim të eliminimit të rreziqeve potenciale që mund të cenonin standardet higjienike.

Sektori i Sigurimit Fizik

Ndërmarrja vazhdon të sigurohet fizikisht përmes operatorit ekonomik të kontraktuar nga Komuna e Prishtinës, **Besa Security**, njësoj si në objektin e mëparshëm në lagjen Ulpiana.

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar komunikime me operatorin ekonomik dhe me Drejtorinë e Emergjencave, pasi kishte një iniciativë që sigurimi fizik i ndërmarrjes të mos administrohej më nga Komuna e Prishtinës.

Duke marrë parasysh rëndësinë strategjike të objektit dhe vështirësitë procedurale për sigurimin e një kontrate të re në afat të shkurtër, Drejtoria e Emergjencave ka vazhduar të garantojë mbulimin me sigurim fizik të objektit.

Megjithatë, Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta konsideron se në një të ardhme të afërt ndërmarrja duhet të planifikojë kontraktimin e pavarur të shërbimit të sigurimit fizik, në mënyrë që të sigurojë qëndrueshmëri institucionale dhe të minimizojë rreziqet operative.

Konkluzione

Bazuar në aktivitetet e realizuara gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026, konstatohet se Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta ka përmbushur me përgjegjësi dhe profesionalizëm detyrat dhe obligimet e tij, duke kontribuar në funksionimin normal dhe efikas të ndërmarrjes.

Departamenti do të vazhdojë të orientojë punën e tij në përputhje me objektivat strategjike dhe planifikimet e N.P.L. "Ku'zina" Sh.A., me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve, rritjen e efikasitetit operacional dhe ofrimin e një shërbimi sa më cilësor për qytetarët.

Me angazhimin e stafit dhe mbështetjen e menaxhmentit, departamenti mbetet i përkushtuar që t'u përgjigjet në mënyrë profesionale dhe në kohë të gjitha kërkesave institucionale, duke kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të ndërmarrjes dhe forcimin e rolit të saj në shërbim të komunitetit.

FURNIZIMI DHE PRODHIMI

Ky raport paraqet aktivitetet e realizuara në sektorin e furnizimit dhe prodhimit gjatë Tremujorit II të vitit 2026, me fokus në monitorimin e furnizimeve, procesit të prodhimit, kontrollin e cilësisë dhe respektimin e standardeve të sigurisë ushqimore.

Furnizimi

Gjatë Tremujorit II të vitit 2026 është monitoruar vazhdimisht procesi i furnizimit me lëndë të para dhe materiale të nevojshme për funksionimin e rregullt të ndërmarrjes.

Në kuadër të këtij procesi janë kryer:

- kontrolli i pranimit të mallrave sipas specifikimeve kontraktuale;
- verifikimi i cilësisë dhe sasisë së produkteve të pranuara;
- kontrolli i afatit të përdorimit të produkteve;
- kontrolli i kushteve të transportit dhe ruajtjes së produkteve ushqimore;
- evidentimi i rasteve të mospërputhjes dhe raportimi i tyre për trajtim sipas procedurave të brendshme.

Falë monitorimit të vazhdueshëm, është mundësuar identifikimi në kohë i mospërputhjeve dhe ndërmarrja e masave korrigjuese për ruajtjen e standardeve të cilësisë dhe sigurisë ushqimore.

Prodhimi

Gjatë periudhës raportuese është monitoruar procesi i prodhimit të shujtave, me fokus në:

- zbatimin e procedurave standarde të punës;
- respektimin e kërkesave të sistemit HACCP;
- higjienën personale dhe higjienën e ambienteve të punës;
- kontrollin e cilësisë së produkteve ushqimore;
- respektimin e kërkesave të sigurisë ushqimore gjatë të gjitha fazave të prodhimit.

Mangësitë e evidentuara gjatë monitorimit janë trajtuar përmes masave korrigjuese dhe udhëzimeve përkatëse, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të prodhimit.

Prodhimi i shujtave gjatë Tremujorit II 2026

Kategoria	Prill	Maj	Qershor
Institucionet Parashkollore Publike	31,446	30,908	32,970
Institucionet Parashkollore me bazë në komunitet	16,243	15,534	18,816
Qendrat Sociale	5,700	5,400	6,600
Qendrat Sociale për të Moshuar	5,781	5,910	5,898
Brigada Profesionale e Zjarrfikësve – Prishtinë	1,875	1,978	1,830
Shkollat Fillore me Mësim Tërë ditor	68,300	74,866	55,916
Shërbime Catering	90	630	195
Porosi private	481	345	468

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se numri më i madh i shujtave është prodhuar për shkollat fillore me mësim tërëditor dhe institucionet parashkollore, të cilat përbëjnë edhe pjesën më të madhe të aktivitetit operativ të ndërmarrjes.

Rënia e numrit të shujtave gjatë muajit qershor për shkollat fillore lidhet me përfundimin e vitit shkollor, ndërsa rritja e numrit të shujtave për institucionet parashkollore dhe qendrat sociale pasqyron vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve gjatë sezonit veror.

Rekomandime për Tremujorin III

Për të përmirësuar më tej proceset e furnizimit dhe prodhimit, rekomandohen këto masa:

- rritja e monitorimit të proceseve të furnizimit dhe prodhimit;
- forcimi i ndërgjegjësimit të stafit për zbatimin e procedurave të cilësisë dhe sigurisë ushqimore;
- përmirësimi i planifikimit të furnizimeve në përputhje me nevojat operative;
- forcimi i bashkëpunimit me operatorët ekonomikë për të siguruar furnizime cilësore dhe në kohë;
- vazhdimi i monitorimit të zbatimit të sistemit HACCP dhe procedurave të kontrollit të cilësisë.

Konkluzione

Gjatë Tremujorit II të vitit 2026, proceset e furnizimit dhe prodhimit janë zhvilluar në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me standardet e përcaktuara të cilësisë dhe sigurisë ushqimore.

Monitorimi i vazhdueshëm i furnizimeve, kontrolli i procesit të prodhimit dhe ndërmarrja e masave korrigjuese kanë kontribuar në ruajtjen e cilësisë së produkteve dhe ofrimin e një shërbimi të sigurt për të gjithë përfituesit.

Edhe gjatë Tremujorit III do të vazhdohet me përmirësimin e proceseve operative, rritjen e efikasitetit dhe forcimin e kontrolleve të brendshme, me qëllim përmbushjen e standardeve më të larta të cilësisë dhe sigurisë.

MENAXHIMIN E KONTRATAVE


Ky raport ka për qëllim të përmbledh aktivitetet dhe përgjegjësitë që jane realizuar gjatë periudhës tre mujorit te dyte të vitit 2026 në lidhje me menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës për të siguruar që kontratat kanë qenë efektive dhe kanë sjellë rezultate të dëshiruara për palët sipas kritereve te përcaktuara ne kontratat aktive .

Aktivitetet kanë përfshirë shqyrtimin e kontratave, monitorimin e zbatimit të tyre, si dhe evidentimin dhe mbikëqyrjen e proceseve të ndryshme lidhur me kontratat aktive si :

- Shqyrtimi i kontratave.
- Monitorimi i zbatimit të kontratave.
- Raportimi dhe analiza e kontratave.
- Specifikimet e faturave apo flet-dërgesave.
- Konstatimi për pagesa për 26 kontrata aktive dhe te perfunduara .
- Evidenca në specifikacione sipas flet-dërgesave dhe faturave që janë pranuar nga menaxherët e caktuar..

Ky raport shqyrton efektivitetin financiar të kontratës dhe koston totale të furnizimit për periudhën TM2 2026 te kontratave aktive dhe kontratave te reja :

Nr	FURNIZIME - Emertimi kontratave me AQP-n (2025-2026)	Prill 2026	Maj 2026	Qershor 2026	Total
1	Furnizim me mish gjedhi dhe produkte të mishit të gjedhit- Loti 1	€ 6 580,00	€ 4 372,00	€ 2 960,00	€ 13 912,00
2	Furnizim me mish pule dhe produkte të mishit të pulës. Loti 2	€ 1 620,00	€ 2 313,00	€ 1 052,00	€ 4 985,00
3	Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit -Loti 3	€ 2 615,00	€ 4 141,00	€ 5 785,01	€ 12 541,01
4	Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor - Loti 4	€ 3 858,18	€ 2 841,70	€ 2 210,63	€ 8 910,51
5	Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor - Loti 5	€ 5 849,38	€ 3 860,60	€ 3 708,61	€ 13 418,59
7	Furnizim me karburant ne rajonin e Prishtines	€ 1 100,08	€ 1 272,66		€ 2 372,74
8	Furnizimi me uje te pijes	€ 317,76	300,96	€ 601,92	€ 1 220,64
	FURNIZIME - Emertimi kontratave per KQ-n (2025- 2026)				€ 0,00
9	Furnizim me artikuj te ndryshem ushqimor - Drithera	€ 1 038,00	€ 2 231,50	€ 1 038,00	€ 4 307,50
10	Furnizim me material Higjientik		€ 667,92		€ 667,92
11	Furnizim me paketime ushqimore	€ 965,00	€ 4 610,00	€ 2 419,00	€ 7 994,00
12	Furnizimi me Vetura PICk -UP (36 muaj)	€ 7 984,00	€ 7 984,00	€ 7 984,00	€ 23 952,00
13	Furnizim me Peme dhe Perime (6 Muaj)	€ 20 671,30	€ 19 599,24	€ 17 489,25	€ 57 759,79
14	Furnizim me peshk dhe produkte te peshkut	€ 12 350,80	€ 29 358,70		€ 41 709,50
15	Furnizim me buke dhe brumera - Premium Bakery (12 Muaj)	€ 13 577,15	€ 18 047,45	€ 19 912,25	€ 51 536,85
16	Furnizim me material administrativ per zyre		€ 457,03		€ 457,03
	Sherbime - Emertimi kontratave per KQ-n (2025 - 2026)				€ 0,00
17	Mirembajtja dhe sevisimi I Automjeteve		€ 843,00		€ 843,00
18	Sigurimi shendetsor dhe aksidental per punëtoret e Kuzhines Qendrore	€ 1 959,20	€ 1 959,20	€ 1 959,20	€ 5 877,60
19	Shendrrimi I veturave Pick- Up nga situata standarde ne sisitem me frigo -Loti 1 dhe Loti 2	€ 9 650,00			€ 9 650,00
20	Krijimi I identitetit (Brendimi)dhe prezantimi medial per npl Ku'zina .			€ 30 031,00	€ 30 031,00
21	Pajisje te IT-s me Qera	€ 1 874,00	€ 1 874,00	€ 1 874,00	€ 5 622,00
22	Kontrata mbi qiran te objektit te kuzhines	€ 17 940,00	€ 17 940,00	€ 17 940,00	€ 53 820,00
23	Kontrata mbi qirane e parkingut (4 parkinge nr : 148,149,152,153)	€ 433,03	€ 433,03	€ 433,03	€ 1 299,09
	Sherbime - Emertimi I kontratatave ne mes institucioneve publike dhe ndermarrjeve publike lokale				€ 0,00
24	Biltetat e veqanta per staf (te hershum) (nuk ka vlere te caktuar)	€ 771,78	€ 731,16		€ 1 502,94
25	Kontrata me IKSHPK-n	€ 324,00			€ 324,00
26	Kontrata me NPB per sherbime te Riparimit dhe mirembajtjes .				€ 0,00
27	Kontrat ne shtepi me NPB-n per sherbime te pastrimit	€ 1 507,52	€ 1 507,52	€ 1 507,58	€ 4 522,62
	Total vlera financiare:				**€ 359 237,33**



Gjate kësaj periudhe ndërmarrja ka zhvilluar aktivitete te furnizimit dhe shërbimit me gjithsej 27 operator, te cilët i kemi nda ne 4 kategori me përshkrim sipas tabelës se me sipërme:

- Kontrata aktive te furnizimit me Agjencinë qendrore te prokurimit
- Kontrata aktive te furnizimit me Zyrën e Prokurimit te ndërmarrjes
- Kontrata aktive shërbyese
- Kontrata shërbyese – marrëveshje bashkëpunimi me institucionet publike dhe lokale.

Përshkrimi i ndryshimit - *Kontratat me AQP 2025/2026*

Kategoria e furnizimeve	2025- TM2	2026- TM2	Ndryshimi ne Euro	% Ndryshimi	
Lot 3 - BYlmeti	14 261,86 €	12 541,02 €	- 1 720,84 €	-12,07%	Zbritje
Lot 5 – Artikuj ushqimor	18 300,40 €	13 418,61 €	- 4 881,79 €	-26,68%	Zbritje
Lot 4- Artikuj ushqimor	10 330,06 €	8 910,53 €	- 1 419,53 €	-13,74%	Zbritje
Karburanti	1 565,62 €	2 373,62 €	808 €	51,61%	Rritje
Mish i kuq	11 403,10 €	13 912,00 €	2 508,90 €	22,00%	Rritje
Mish i pulës	10 905,43 €	4 985,00 €	- 5 920,43 €	-54,29%	Zbritje
Uji	315.68 €	1 220,64 €	904,96 €	286,67%	Rritje
Totali	**67 082,15 €**	**57 361,42 €**	**- 9 720,73 €**	**6.98%**	

Kontratat me KQ 2025/2026

Kategoria	2025 TM2	2026 TM2	Ndryshimi ne Euro	% Ndryshimi	
Drithëra	3 586,80 €	4 061,50 €	474.70 €	13,23%	Rritje
Pemë & perime		57 759,79 €	57 759,79 €	0,00%	
Bukë	39 880,45 €	51 536,85 €	11 656,40 €	29,23%	Rritje
Higjiena	744.90 €	667.92 €	-76.98 €	-10,33%	Ulje
Furnizimi me v. pikate	23 952,00 €	23 952,00 €	- €	0,00%	Stabilitet
Paketime	2 240,41 €	7 994,00 €	5 753,59 €	256,81%	Rritje
Sigurimi shendetsor dhe aksidental	5 927,20 €	5 877,60 €	- 49,60 €	-0,84%	Stabilitet
Totali:	**76 331,76 €**	**151 849,66 €**	**75 517,90 €**	**288,10%**	

Sipas tabeles mund te konstatojm se kemi rritje te theksuara te furnizimeve ne mes te 2 periudhave krahasuese ne kater ktegorit kryesore si :

- Uje 286.67 %
- Paketime ushqimore 256.81%
- Bukë 29.23%

Qëllimi i raportit është të ofrojë një pasqyrë të progresit të punimeve, sfidave të hasura dhe parashikimeve për përfundimin e tyre.

Gjate kësaj periudhe janë nënshkruar 2 kontrata afatgjate me OE si :

- Furnizim me material shpenzues për zyre
- Furnizimi me paketime ushqimore

Përmes KRPP-s janë azhurnuar raportet pjesërisht te kontratave te përfunduara nga zyrtaret e zyrës për menaxhim te kontratave me OE duke u bazuar ne procedurat e menaxhimit dhe përmbylljes se kontratave sipas e-Prokurimit .

BURIMET NJERËZORE

Qëllimi i këtij raporti është të paraqesë aktivitetet e realizuara nga Zyra e Burimeve Njerëzore gjatë periudhës 01 prill 2026 – 30 qershor 2026, duke ofruar një pasqyrë të punës së zhvilluar, rezultateve të arritura, sfidave të hasura dhe masave të ndërmarra për menaxhimin dhe përmirësimin e proceseve të burimeve njerëzore në N.P.L. "Ku'zina" Sh.A.

Organizimi i stafit

Gjatë Tremujorit II të vitit 2026, numri i punonjësve është menaxhuar në përputhje me strukturën organizative dhe nevojat operative të ndërmarrjes.

Struktura e stafit

Raporti gjinor

Meshkuj: 18

Femra: 60

Struktura sipas grupmoshave

Grupmosha	Numri i punonjësve
20–30 vjeç	9
31–40 vjeç	17
41–50 vjeç	22

51–60 vjeç 21

61–65 vjeç 9

Gjatë periudhës raportuese, menaxhimi i pushimeve vjetore është realizuar në përputhje me planifikimin e bërë nga Zyra e Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me drejtuesit e departamenteve.

Deri në fund të muajit qershor 2026, të gjithë punonjësit kanë shfrytëzuar ditët e mbetura të pushimit vjetor nga viti 2025, në përputhje me planin e pushimeve dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Po ashtu, janë administruar dhe evidentuar edhe ditët shtesë të pushimit që rrjedhin nga përvoja e punës, duke garantuar trajtim të drejtë dhe të barabartë për të gjithë punonjësit.

Bashkëpunimi ndërmjet Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe drejtuesve të njësive organizative ka qenë i vazhdueshëm dhe efikas, duke mundësuar realizimin e pushimeve pa ndikuar në mbarëvajtjen e proceseve të punës.

Disiplina në punë

Gjatë Tremujorit II të vitit 2026, Zyra e Burimeve Njerëzore ka vazhduar monitorimin e respektimit të rregullave të punës, procedurave të brendshme dhe standardeve të përcaktuara nga ndërmarrja.

Duke pasur parasysh rëndësinë e paraqitjes profesionale, higjienës dhe respektimit të standardeve të punës në institucionet arsimore ku ndërmarrja ofron shërbime, punonjësit janë pajisur me uniforma pune me qëllim të sigurimit të një paraqitjeje profesionale dhe identifikimit të tyre gjatë kryerjes së detyrave.

Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar raste të mosrespektimit të detyrimit për përdorimin e uniformave të punës nga disa punonjës të angazhuar në shërbimin e ushqimit në institucionet arsimore.

Për këto raste janë ndërmarrë masa disiplinore dhe janë lëshuar gjithsej 9 vërejtje me shkrim, me qëllim përmirësimin e respektimit të standardeve të punës.

Gjithashtu, janë evidentuar raste të mosrespektimit të orarit të punës nga disa punonjës të Departamentit të Shërbimeve të Përbashkëta, konkretisht në sektorin e shpërndarjes së ushqimit.

Për këto raste janë lëshuar gjithsej 6 vërejtje me shkrim, duke kërkuar respektimin rigoroz të obligimeve të punës dhe sigurimin e vazhdimësisë së shërbimeve që ofron ndërmarrja.

Zyra e Burimeve Njerëzore do të vazhdojë monitorimin sistematik të disiplinës në punë dhe, në rast të përsëritjes së shkeljeve, do të ndërmarrë masat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të ndërmarrjes.

Trajnimet dhe zhvillimi profesional

Në kuadër të zhvillimit profesional dhe ngritjes së kapaciteteve të punonjësve, gjatë Tremujorit II të vitit 2026 është organizuar trajnimi me temë:

- "Komunikimi, bashkëpunimi dhe menaxhimi i stresit".

Trajnimi ka zgjatur 6 orë dhe ka pasur për qëllim përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet departamenteve të ndërmarrjes, me fokus të veçantë në koordinimin ndërmjet administratës, kuzhinës operative dhe sektorit të logjistikës.

Gjatë trajnimit janë trajtuar temat në vijim:

- përmirësimi i komunikimit të brendshëm;
- forcimi i bashkëpunimit ndërmjet ekipeve të punës;
- menaxhimi efektiv i situatave stresuese gjatë periudhave me ngarkesë të lartë pune;
- zhvillimi i metodave praktike për përballimin e sfidave të përditshme në ambientin e punës.

Ky aktivitet ka kontribuar në forcimin e kulturës së bashkëpunimit, përmirësimin e koordinimit ndërmjet njësive organizative dhe krijimin e një mjedisi pune më funksional, më produktiv dhe më bashkëpunues.

Konkluzione

Gjatë Tremujorit II të vitit 2026, Zyra e Burimeve Njerëzore ka realizuar me sukses aktivitetet e planifikuara në fushën e administrimit të personelit, organizimit të stafit, menaxhimit të pushimeve, monitorimit të disiplinës në punë dhe zhvillimit profesional të punonjësve.

Rezultatet e arritura dëshmojnë angazhimin e vazhdueshëm për krijimin e një mjedisi pune të organizuar, profesional dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të ndërmarrjes.

Edhe në periudhat e ardhshme, Zyra e Burimeve Njerëzore do të vazhdojë të punojë në forcimin e kapaciteteve profesionale të stafit, përmirësimin e proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe ngritjen e standardeve organizative, me synim rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve të N.P.L. "Ku'zina" Sh.A.

ZYRA E PROKURIMIT

Gjatë Tremujorit II të vitit 2026, Zyra e Prokurimit ka zhvilluar aktivitetet e saj në përputhje me Planin e Prokurimit të miratuar për vitin 2026 dhe me legjislacionin në fuqi.

Fokusi kryesor i punës ka qenë zhvillimi i procedurave të prokurimit për sigurimin e furnizimeve dhe shërbimeve të nevojshme për funksionimin e rregullt dhe të pandërprerë të N.P.L. "Ku'zina" Sh.A., duke respektuar parimet e transparencës, konkurrencës, trajtimit të barabartë dhe përdorimit racional të mjeteve financiare.

Procedurat e realizuara gjatë Tremujorit II 2026

Gjatë periudhës raportuese janë përfunduar procedurat e mëposhtme të prokurimit:

Përshkrimi i procedurës	**Vlera (€)**
Auditimi i pasqyrave financiare	980.00
Furnizim me paketime ushqimore	22,684.40
Furnizim me pemë dhe perime	97,284.00
Furnizim me material shpenzues për zyrë	3,536.05

Vlera totale e procedurave të realizuara gjatë Tremujorit II 2026 është 124,484.45 euro.

Këto procedura janë zhvilluar sipas planifikimit vjetor të prokurimit dhe kanë siguruar vazhdimësinë e furnizimeve dhe shërbimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarisë së ndërmarrjes.

Procedurat në proces

Gjatë Tremujorit II të vitit 2026 janë iniciuar procedura të reja të prokurimit, të cilat aktualisht ndodhen në fazën e përgatitjes së specifikimeve teknike dhe dokumentacionit të tenderit.

Procedurat në proces janë:

Procedura	Vlera e parashikuar (€)
Sigurimi shëndetësor dhe aksidental	150,000.00
Furnizim me peshk dhe produkte të peshkut	310,000.00

Në vijim do të realizohet përgatitja e dokumentacionit teknik, publikimi i procedurave dhe zhvillimi i të gjitha fazave të prokurimit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe Planin e Prokurimit për vitin 2026.

Konkluzione

Gjatë Tremujorit II të vitit 2026, Zyra e Prokurimit ka realizuar me sukses procedurat e planifikuara të prokurimit, duke kontribuar në sigurimin me kohë të mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për funksionimin e pandërprerë të N.P.L. "Ku'zina" Sh.A.

Njëkohësisht, janë ndërmarrë veprimet për fillimin e procedurave të reja me rëndësi strategjike për ndërmarrjen, të cilat do të zhvillohen gjatë periudhës së ardhshme.

Zyra e Prokurimit mbetet e përkushtuar në zbatimin e praktikave të mira të prokurimit publik, duke garantuar transparencë, efikasitet, konkurrencë të drejtë dhe përdorim racional të mjeteve financiare, në funksion të realizimit të objektivave strategjike të ndërmarrjes.

KONTROLLI I CILËSISË DHE SIGURISË USHQIMORE

Ky raport paraqet aktivitetet e realizuara nga Zyra për Kontrollin e Cilësisë dhe Sigurisë Ushqimore gjatë **Tremujorit II të vitit 2026**. Raporti përmbledh monitorimin e proceseve të prodhimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së ushqimit, rezultatet e kontrolleve të kryera, analizat laboratorike, inspektimet e realizuara dhe masat korrigjuese të ndërmarra, me qëllim garantimin e cilësisë dhe sigurisë ushqimore në përputhje me standardet HACCP dhe legjislacionin në fuqi.

Aktivitetet kryesore

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar aktivitetet në vijim:

- Kontrolli i temperaturës së magazinimit dy herë në ditë, me rezultate brenda kufijve të lejuar gjatë gjithë periudhës raportuese.
- Auditimi i higjienës së stafit në baza mujore, me **100% pajtueshmëri** me protokollet e higjienës.
- Analiza mikrobiologjike të ushqimeve dy herë në muaj, pa evidentim të kontaminimeve në mostrat e analizuara.
- Marrja dhe analizimi i mostrave të ujit për analiza mikrobiologjike dhe fiziko-kimike, të cilat kanë konfirmuar se uji është i pijshëm dhe i përshtatshëm për përgatitjen e ushqimit.
- Inspektimi i pajisjeve të kuzhinës në baza javore, me një nivel funksionaliteti prej **95%**.
- Inspektime dhe marrje mostrash në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) në **12 shkolla me mësim tërëditor**.
- Kontrolli sistematik i afateve të përdorimit të produkteve ushqimore në depo.

- Kontrolli i kushteve të ruajtjes së produkteve ushqimore dhe evidentimi i gjetjeve gjatë inspektimeve.

Përmbledhje e aktiviteteve të kontrollit

Gjatë Tremujorit II janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

Aktiviteti	Frekuenca	Rezultati	Statusi
Kontrolli i temperaturës së magazinimit	2 herë në ditë	Brenda normave	✓
Kontrolli i higjienës së stafit	2 herë në muaj	100% pajtueshmëri	✓
Inspektimi i pajisjeve të kuzhinës	2 herë në javë	95% funksionalitet	Kërkohen riparime të pjesshme
Kontrolli i temperaturës në dhomat e parapërgatitjes	2 herë në ditë	Brenda normave	✓
Inspektimi i pastrimit gjeneral të kuzhinës	1 herë në javë	Brenda normave	✓
Marrja e mostrave të ushqimit	Çdo ditë sipas planit	Brenda normave	✓
Analiza mikrobiologjike e ushqimeve	2 herë në muaj	Brenda normave	✓
Analiza fiziko-kimike e ushqimeve	Sipas nevojës	Brenda normave	✓
Analiza fiziko-kimike dhe mikrobiologjike e ujit	1 herë në tremujor	Brenda normave	✓
Kontrolli i mishit të freskët gjatë pranimit	1–2 herë në javë	Brenda normave	✓

Konkluzione

Gjatë Tremujorit II të vitit 2026, sistemi i kontrollit të cilësisë dhe sigurisë ushqimore ka funksionuar në mënyrë efektive, duke garantuar monitorim të vazhdueshëm të proceseve të prodhimit, magazinimit dhe shpërndarjes së ushqimit.

Kontrollet e rregullta, analizat laboratorike dhe bashkëpunimi me IKSHPK kanë mundësuar identifikimin në kohë të rasteve të mospërputhjes dhe ndërmarrjen e menjëhershme të masave korrigjuese.

Në periudhën e ardhshme do të vazhdohet me forcimin e kontrolleve të brendshme, zbatimin rigoroz të sistemit HACCP, monitorimin e standardeve të higjienës dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të sigurisë ushqimore, me qëllim garantimin e ushqimit të sigurt dhe cilësor për të gjithë përfituesit e shërbimeve të N.P.L. "Ku'zina" Sh.A.

KONKLUZION

Bazuar në aktivitetet dhe rezultatet e prezantuara në këtë raport, konstatohet se **N.P.L. "Ku'zina" Sh.A.** gjatë **Tremujorit II të vitit 2026** ka realizuar me sukses objektivat kryesore operacionale dhe administrative, duke siguruar funksionim të qëndrueshëm të proceseve të punës dhe ofrim të pandërprerë të shërbimeve për institucionet përfituese.

Gjatë kësaj periudhe, ndërmarrja ka garantuar përgatitjen dhe shpërndarjen e **388,180 shujtave**, duke respektuar standardet e cilësisë dhe sigurisë ushqimore në të gjitha fazat e procesit. Kontrollet e vazhdueshme, analizat laboratorike, monitorimi i furnizimeve dhe zbatimi i sistemit HACCP kanë kontribuar në ruajtjen e nivelit të lartë të sigurisë ushqimore dhe në identifikimin e hershëm të mospërputhjeve, për të cilat janë ndërmarrë masa korrigjuese.

Në aspektin administrativ dhe organizativ, janë realizuar me sukses procedurat e planifikuara të prokurimit, është monitoruar zbatimi i kontratave aktive, janë zhvilluar aktivitetet e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe janë organizuar trajnime për ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit. Po ashtu, Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta ka siguruar mbështetjen e nevojshme operative për funksionimin e përditshëm të ndërmarrjes.

Raporti evidenton gjithashtu rëndësinë e bashkëpunimit me institucionet publike, partnerët kontraktues dhe organizatat mbështetëse, si dhe angazhimin e vazhdueshëm të ndërmarrjes në aktivitete me përgjegjësi sociale, të cilat kanë kontribuar në përmbushjen e misionit të saj në shërbim të qytetarëve.

Megjithëse gjatë periudhës raportuese janë evidentuar disa sfida dhe mospërputhje operative, ato janë trajtuar në kohë përmes masave korrigjuese dhe përmirësuese, duke krijuar bazë për rritjen e mëtejshme të efikasitetit dhe cilësisë së proceseve të punës.

Në periudhën e ardhshme, N.P.L. "Ku'zina" Sh.A. do të vazhdojë të fokusohet në përmirësimin e proceseve operative, forcimin e kontrollit të brendshëm, zhvillimin profesional të stafit, avancimin e standardeve të sigurisë ushqimore, optimizimin e menaxhimit të burimeve dhe zbatimin e objektivave strategjike të ndërmarrjes. Përmes një qasjeje profesionale, transparente dhe të orientuar drejt rezultateve, ndërmarrja mbetet e

përkushtuar për të ofruar shërbime cilësore, të sigurta dhe efikase, në përmbushje të interesit publik dhe nevojave të qytetarëve të Komunës së Prishtinës.